



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

Nr. Prot. 1445/6 Vlorë, 17.10. 2025



FEDERATA SHQIPTARE E SPORTIT UNIVERSITAR

Nr. Prot. 120 Vlorë, 17.10. 2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE

&

FEDERATA SHQIPTARE E SPORTIT UNIVERSITAR

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, si institucion publik me statusin "Person Juridik Publik" përfaqësuar nga Prof. Dr. Aurela Saliaj në cilësinë e Rektorit si përfaqësuesi ligjor për çështjet akademike dhe protokollare dhe autoriteti më i lartë akademik,

&

Federata Shqiptare e Sportit Universitar, me seli në Parkun Olimpik "Feti Borova", Tiranë, person juridik privat në formën e shoqatës, përfaqësuar nga Z. Besnik Veliu, në funksionin e Presidentit

Me qëllim zhvillimin interesin e përbashkët, duke vlerësuar kontributin dhe dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin e përbashkët ndërinstitucional, palët bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë "**Marrëveshja**")



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 1 **Qëllimi i marrëveshjes**

1. Marrëveshja ka për qëllim thellimin e bashkëpunimit në fushën e sportit universtiar;
2. Organizimin e ekipeve sportive studentore të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe pjesëmarrjen në aktivitete sportive universitare në nivel Evropian dhe ndërkombëtar;
3. Të inkurajojnë, regullojnë dhe nxisin pjesëmarrjen e studentëve në nivele amatore dhe garuese, në aktivitete sportive-social-kulturore, si një faktor kyç në edukimin dhe formimin e tyre;
4. Realizimin e trajnimeve dhe seminareve për studentë, pedagogë, trajnerë dhe ekspertë të sportit;
5. Shkëmbimin e ekspertizës, përvojës dhe praktikave të mira në fushën e sportit universitar dhe vullnetarizmit në sport;
6. Promovimin e vlerave të sportit, masivizimit të tij dhe edukimit përmes sportit në komunitetin universitar;
7. Organizimin e Turneut Ballkanik në qytetin e Vlorës në sportet e plazhit.

Neni 2 **Baza ligjore**

1. Zhvillimi i praktikës mësimore bazohet në ligjin 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjin 79/2017 "Për sportin".

Neni 3 **Fushat e Bashkëpunimit**

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në fushat:

1. Organizimi i aktiviteteve sportive në Universitet;
2. Pjesëmarrja e studentëve në Kampionatet Kombëtare Universitare të organizuara nga
3. FSHSU;
4. Promovimi i sporteve individuale dhe ekipore;
5. Trajnime dhe seminare për stafin dhe studentët mbi temat e sportit, shëndetit dhe menaxhimit
6. sportiv;
7. Krijimi i ekipeve sportive zyrtare të Universitetit me mbështetjen e Federatës;
8. Përdorimi i infrastrukturës sportive në mënyrë të ndërsjellë dhe të organizuar.

Neni 4 **Detyrimet e palëve**

1. FSHSU angazhohet të:

- a) Mbështesë Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë në përfshirjen dhe organizimin e studentëve në veprimtari sportive;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- b) Sigurojë regjistrimin e universitetit në aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare të sportit universitar;
- c) Sigurojë regjistrimin e studentëve në aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare të sportit universitar;
- d) Promovojë pjesëmarrjen e studentëve-sportistë të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë në aktivitetet kombëtare, Evropiane dhe ndërkombëtare;
- e) Ofrojë trajnime, seminare dhe asistencë teknike sipas nevojave të identifikuara bashkërisht.

2. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë angazhohet të:

- a) Nxisë dhe mobilizojë studentët për pjesëmarrje aktive në sport;
- b) Vendosë në dispozicion ambiente për organizimin e aktiviteteve sportive;
- c) Bashkëpunojë në nivel organizativ me Federatën.
- d) Paguajë, kuotën e antarësimit prej 100.000 lekë në vit, afat i cili llogaritet nga nënshkrimi i marrëveshjes.
- e) Të njohë dhe respektojë ekskluzivitetin e Federatës Shqiptare të Sportit Universitar në ushtrimin e atributeteve dhe kompetencave që i janë njohur me ligj, pa miratimin e mëparshëm zyrtar të Federatës;
- f) Bashkëorganizojë aktivitete sportive në nivel lokal, qoftë të një sporti të vetëm apo të shumë sporteve, në bashkëpunim dhe me koordinimin e Federatës Shqiptare të Sportit Universitar, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 79/2017 "Për Sportin", i ndryshuar;
- g) Të ruajë dhe mbrojë integritetin e sportit universitar, duke mos u angazhuar në veprimtari të personave juridikë, privatë ose publikë, që ushtrojnë kompetencat ekskluzive të Federatës Shqiptare të Sportit Universitar, pa miratimin zyrtar të kësaj federate.
- h) Sigurojë mbështetje financiare për akomodimin dhe transportin e ekipit të tij përfaqësues në eventet ku Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dëshiron të marrë pjesë: ngjarje sportive kombëtare të organizuara nga FSHSU, ngjarje sportive Evropiane të organizuara nga Federata Evropiane e Sportit Universitar (EUSA) dhe ngjarje sportive botërore të organizuara nga Federata Botërore e Sportit Universitar (FISU)
- i) Sigurojë mbështetje logjistike dhe pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe stafit akademik në aktivitetet e planifikuara në kalendarin vjetor;

Neni 5

Respektimi i marrëveshjes

1. Institucionet bien dakord që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshesh të punës, motit të keq, "Fuqisë Madhore" ose shkaqeve të tjera objektive të cilat janë të pashmangshme, shkaktuar përtej mundësisë që kanë ato për t'i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse institucionet nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi e tyre nuk do të konsiderohet si prishje e Marrëveshjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 6 Mirëbesimi

1. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë dhe Federata Shqiptare e Sportit Universitar do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjelltë.
2. Palët duhet të rruajnë dhe të administrojnë me mirëbesim të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 7 Afati i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje 3 (tre) vjeçare nga data e nënshkrimit.
2. Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim.
3. Marrëveshja mund të zgjidhet nga secila Palë, nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër, të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara.

Neni 8 Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi


1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Kjo marrëveshje është hartuar në 2(dy) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, 1(një) kopje do të depozitohen në Rektoratin e Universitetit Vlorë, 1(një) kopje do të depozitohet në Federata Shqiptare e Sportit Universitar.

PËR

**UNIVERSITETIN
"ISMAIL QEMALI" VLORE**

REKTOR

PROF. DR. AURELA SALIAJ



PËR

**FEDERATA SHQIPTARE
E SPORTIT UNIVERSITAR**

PRESIDENT

BESNIK VELIU

